



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 58 Prot

Tiranë, më 12.05. 2010

VENDIM Nr. 4 dt. 04.05.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 04.05.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

I. Lidhur me: IV. Diskutimi i projekteve të financuara nga donacione private:

1. Nuk u miratua: "Projekt-ide e restaurimit dhe rivitalizimit të dy kullave dhe portës Egnatia, të cilat ndodhen në Kalanë e Elbasanit". **Projekti do të rishqyrtohet në Këshillin Shkencor, duke u mbështetur në parimin e ruajtjes së monumentit dhe asaj ç'ka monumenti dëshmon për të shkuarën, me dëshirën dhe zgjidhjen për ta rivitalizuar atë.**
2. **Miratohet:** Projekt restaurimi, Ura e Velabishtit, Berat.
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi shtëpia e Babametove, Kat I, Gjirokastrë.
4. **Miratohet:** Projekt restaurimi shtëpia e Babametove, Kat II, Gjirokastrë.
5. **Miratohet në parim:** Projekt ide restaurimi për qëllime muzeale dhe vënien në përdorim të Amfiteatrit të Durrësit. **Të gjithë projektet e zbatimit sipas fazave të punimeve, pasi të hartohen do të kalojnë për tu shqyrtuar në KKR.**
6. **Miratohet:** Projekt restaurimi Manastiri i Shën Prodhromit, Voskopojë.

II. Diskutimi i kërkesave të qytetarëve

1. **Miratohet:** Kërkesë për rikonstrukcion banese me pronar Fatmir Lame, Elbasan. (Gërmimet të jenë nën mbikëqyrjen e ASHA-s, nëse gjatë gërmimeve arkeologjike gjenden përbërje arkeologjike të ndërpriten punimet).

32. **Miratohet:** Rikonstrukcion, ndërtim 2 katësh i pronarit Mihal Gërço. (Gërmimet të jenë nën mbikëqyrjen e ASHA-s, nëse gjatë gërmimeve arkeologjike gjenden përbërje arkeologjike të ndërpriten punimet).

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA